

### **Neni 3**

#### **Limitet buxhetore**

Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

### **Neni 4**

#### **Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione**

4.1 Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.

4.2 Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj Komunës.

4.3 Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Komuna.

### **Neni 5**

#### **Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencione**

5.1 Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta në bazë të kërkesës së arsyetuar atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregullore.

5.2 Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.

5.3 Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara në nenin 9 të kësaj Rregullore.

5.4 Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet brenda 30 ditë kalendarike nga parashtrimi i kërkesës.

### **Neni 6**

#### **Përfundimet nga ndarja e subvencioneve**

6.1 Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna. (Prpozim:nëse aktiviteti i individit ose institucionit është ne interes edhe të komunës mund të përfitoj subvencion)

6.2 Përfundim nga paragrafi 1 i këtij Neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe raste emergjente.

6.3 Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin apo me marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 5 (pesë) vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.

## Neni 15

### Kushtet, kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

#### 15.1 Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë përcakton kushtet dhe kriteret të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në;

15.1.1 Fëmijëve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së iu ndahet bursa pa kriteret.

15.1.2 Vlerësimi kandidatëve bëhet me pikë, duke e shumëzuar notën mesatare me koeficientin 5.

15.1.3 Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë dhe numri i pikëve të testit të arritshmërisë (afati i Qershorit dhe Gushtit) dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës.

15.1.4 Janë banorë rezidentë të Komunës së Hanit të Elezit,

15.1.5 Janë student të rregullt, por jo me vet financim,

15.1.6 Të kenë të regjistruar vitin.

15.1.7 Studenti-ja nëse një herë ka perseritur vitin, (ti shtohet apo ndërru fakultetin) humbë të drejtën e bursës

15.1.8 Të jetë student-e i Universitetit Publik të Kosovës.

15.1.9 Për bursë kanë prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores do të plotësohet me studentët e vitit të parë

15.1.10 Një student-e nuk ka të drejtë të marrë dy apo më shumë bursa nga njësitë buxhetore apo burime të ndryshme, përjashtim ka për ato studentë që marrin bursë universitare.

15.1.11 Studenti-ja i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë.

15.1.12 Studenti-ja nëse është në marrëdhënie pune nuk i takon bursa.

15.1.13 Studentët që i takojnë të njëjtës familje që plotësojnë kushtet për përfitimin e bursës prioritet ka vetëm njëri student që ka notë mesatare më të lartë. Nëse dy studentet plotësojnë kushtet për bursë atëherë marrin 75 % secili student....Nëse.. Studentet që kanë notën mesatare mbi 8.5 dhe të njëjtës familje tu epet bursae plotë të dyve).

15.1.13 Studenti-ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejtë aplikimi për bursës.

15.2 Përveç pikëve nga paragrafi paraparak, studentëve që u takojnë kategorive të veçanta u shtohen pikë si në vijim:

15.2.1 Fëmijës së invalidit të luftës i shtohen 20 pikë, (propozohet 10 pikë)

15.2.2 Studenti-ja i cili nuk i ka të dy prindërit i shtohen 20 pikë, (15 pikë)

15.2.3 Studenti-ja i cili ka të dy prindërit e hendikepuar i shtohen 20 pikë, (10 (dëshmi nga Mjeku... librezë)

15.2.4 Fëmijës së veteranit të luftës i shtohen 15 pikë, (10 pikë)

15.2.5 Fëmijës së të burgosurit politikë i shtohen 15 pikë, (deri në 6 muaj 5 pikë, mbi 6 e më tepër 10 pikë?????)

15.2.6 Studenti-ja i cili është hendikep i shtohen 15 pikë, (te dëshmohet me librezë)

15.2.7 Fëmijës së martirit të luftës i shtohen 10 pikë,

15.2.8 Studenti-ja i cili ka njërin prind të hendikepuar i shtohen 10 pikë, (5 pike librezë.

15.2.9 Studenti-ja i cili e ka gjendjen e rëndë sociale i shtohen 15 pikë, (10 pikë)

15.2.10 Studenti-ja me gjendje të rëndë ekonomike që me ligj largohen nga skema sociale për shkak se nuk kanë fëmijë nën moshën pesë vjeçare të u jepet përparësi njëjtë sikur se të rastet sociale i shtohen 15 pikë, (10 pikë)

15.2.11 Studenti-ja i cili nuk e ka njërin prind 10 pikë, 5 pikë

15.2.12 Familja bërthamë që ka dy e më tepër student në fakultetin publikë i shtohen 10 pikë, (Ky nen Propozohet të hiqet sepse tani propozimi është që të marrin të dytë???)

15.2.13 Studenti-ja me notë mesatare 9 e mbi, vlerësohet me 10 pikë, (20 pikë)

15.2.14 Studenti-ja me notë mesatare 8 e mbi, vlerësohet me 5 pikë, (15 pikë)

15.2.15 Studenti-ja me notë mesatare 7 e mbi, vlerësohet me 3 pikë, 5 pikë

15.2.16 Studenti-ja i cili bënë punë vullnetare vlerësohet me 5 pikë, (3 pikë) nëse në vitin shkollor ka bërë punën

15.2.17 15.2.17 Studenti-ja që ka marrë diploma, mirënjohje, certifikata kombëtare ose ndërkombëtare në ndonjë garë – konkurs në lëmin arsimore i shtohen 3 pikë, (nëse në vitin shkollor ka bërë punën).

15.2.18 Tu jepet përparësi studentëve të cilët janë kuadro deficitare, 5 pikë. (10 pikë)

### **15.3 Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, duke mos u kufizuar:**

15.3.1 Certifikata e notave,

15.3.2 Vërtetimi për vitin kalendarik të studimeve;

15.3.3 Deklarata e bashkësisë familjare.

15.3.4 Dëshmia se është invalid i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale.

15.3.5 Certifikatën e vendbanimit,

15.3.6 Diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor

15.3.7 Studentët që janë invalid të luftës, anëtar të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirit të luftës, me gjendje të rëndë sociale, student me aftësi të kufizuara duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat (ti shtohet...dëshmi librezë) dhe institucionet përkatëse.

15.3.8 Dokumenti i identifikimit;

15.3.9 Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;

15.4 Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë

15.5 Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave e cila publikohet në ueb faqen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në media lokale.